



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opstina Istok
Istog Municipality

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

DATË/A:	20.04.2023
REFERENCË:	02/f/2023
PËR/ZA/TO:	Të gjithë anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
CC:	MPB, MAPL, KFOR, OSCE, ICITAP,
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Ilir Ferati, Kryetar
TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT:	Ftesë
VENDI/MJESTO/PLACE	Salla e Kuvendit Komunal- Istog

E/I nderuara/i _____

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) e cila do të mbahet me datë **28.04.2023** në ora **10.00**

Rendi i ditës:

1. Miratimi i Rendit të ditës,
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit
3. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK
4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqësues të komuniteteve etj.)
5. Dhuna në familje, mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore
-Diskriminimi i grave, vajzave dhe personave me aftësi të kufizuara në procedurat e konkurimit pranë institucioneve publike
6. Parkimi i automjeteve në trotuare-pjerrinat në trotuare pengohet levizja e lirë e qytetarëve, në veçanti e personave me nevoja të veçanta
7. Të ndryshme

Pjesëmarrja është e obligueshme për antarët e KKSB-së.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosova



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

Nr:2	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
Data e mbajtjes:	28.03.2023 Ora: 10:00
Vendi i takimit:	Salla e Kuvendit Komunal
Mbledhjen e kryesoi:	Nënkryetari i Komunës: z. Ali Nimanaj
Procesmbajtës:	Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave
Anëtarët e Këshillit:	<ol style="list-style-type: none">1. Ilir Ferati, Kryetar i Këshillit;2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;3. Tahir ef. Bekaj, Bashkësia Islame;4. Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,5. Jerej Nebojsa Sekulliq, Kisha Ortodokse,6. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar;7. Svetlana Đorić, Përfaqësuese e Komunitetit Serb;8. Sead Hotović, Komuniteti Boshnjak;9. Ganimer Shaqiri, Komuniteti Romë;10. Ukë Dollci, Komuniteti Egjiptas;11. Đula Karišik, Komiteti për Komunitete;12. Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore;13. Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim;14. Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë;15. N/Tog. Albestrim Rexhepi, nga FSK;16. Enver Boletini, KLSP-Gurakoc;17. Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë;18. Blendinela Shatri, EVSB;19. Skendr Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;20. Enisa Ćorović, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;21. Blendor Isufaj, KVRL;22. Zeqir Mehmetaj, Radio"Fontana";23. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS;24. Armir Arifaj ShKK Burgu i Dubraves, dhe25. Përfaqësuesi i Komuniteti i Biznesit.
	Mungojnë: Tahir ef. Bekaj, Bashkësia Islame;

Don Alfred Sokoli, Kisha Katolike,
Jerej Nebojsha Sekulliq, Kisha Ortodokse,
Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar
Robert Gegaj, Kryesues i këshillit të prindërve
të Arsimit në Komunë
N/tog. Albestrim Rexhepi, FSK
Gëzim Ademaj, KLSP-Banjë
Blendor Isufaj, KVRL

Pjesëmarrës tjerë:

Florentina Beqiraj, Këshilltare e Ministres së Drejtësisë
Blerim Gerguri, përkthyes, Komuna Istog
Mehmed Qeman, përkthyes, Komuna Istog
Endrit Mehmetaj, RTV Fontana,
Abetare Sutaj, RTV Fontana,
Myrvete Verbaj, Komuna Istog
Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i Urbanizmit, Komuna Istog
Ardn Arifaj, Komuna Istog
Davide Sbrollini, KFOR
Ajshe Qelaj, UNMIK
Abedin Lataj, UNMIK
Edmond Dushi, OSBE

Rendi i ditës:

1. Miratimi i Rendit të ditës,
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit,
3. Siguria në zonën e përgjithëshme të PK -së
4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqësues të komuniteteve etj.)
5. Dhuna në familje, mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore
-Diskriminimi i grave, vajzave dhe personave me aftësi të kufizuara në procedurat e konkurimit pranë institucioneve publike
6. Parkimi i automjeteve në trotuare-pjerrinat në trotuare pengohet levizja e lirë e qytetarëve, në veçanti e personave me nevoja të veçanta
7. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Përshëndet të gjithë të pranishmit, anëtarët e KKSB-së. Përshendet perfaqsesit e KFOR-it Italian, Florentina Beqiraj, Këshilltare e Ministres së Drejtësisë, Myrvete verbaj nga qendra për Punë Sociale Istog, perfaqses të OSBE-së dhe UNMIK-ut dhe gjithë të prënishmit. Materialin për mbledhje e keni pranuar me kohë, prezantoi rendin e ditës para të pranishmëve. Para se ta hudhi në votim rendin e ditës më lejoni të theksoj se Vetëm Blendi Isufaj dhe Jerej Nebijsha Sekulliq kanë lajmruar për mospjesmarrje në mbledhje me arsyetim, ndersa të tjeret nuk kanë lajmruar. Në vazhdim pyeti a ka propozime për ndryshim të rendit të ditës. Me qe nuk ka propozime tëja, miratohet rendi i ditës unanimisht.

2. Miratimi i procesverbalit nga Mbledhja e kaluar

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Pyeti antaret e KKSB-së a ka dikush vrejtje në procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Me qe nuk pati vrejtje, Nënkyetari pyeti kush është për miratimin e procesverbalit. Gjithë antarët e pranishëm të KKSB-së votuan për miratimin e procesverbalit.

3. Siguria në zonën e përgjithshme të PK-së

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - vazhdojmë me piken e rendit të ditës, fjalën ja kalon komandantit të Policis.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog - Ashtu si kam¹ premtuar në mbledhjen e kaluar më lejoni që parajush të prezentoj statistikën për janar-marsë, ndersa për muajt prill në takimin e radhes me që ende nuk është mbyll muaji. Raste të inicuar janë:

- 161 raste të inicuar
- 66.9% zbulueshmeria e rasteve
- nga rastet e inicuar:
- 131 raste janë vepra penale,
- 29 aksidente trafiku
- 4 aksidente me lendime dhe kemi pas 4 persona të lënduar
- 25 aksidente me dëme materiale
- 462 gjoba të shqiptuara në trafik nga zyrtarët policor
- 86 persona të arrestuar
- 23 persona, nga të arrestuarit, me urdhër të prokurorit janë ndaluar për 48 orë
- gjatë kësaj periudhe janë konfiskuar 6 armë dhe 11 copë municion
- 37 asistime të institucioneve të ndryshme.

Gjatë periudhes kohore për të cilën raportojmë nuk kemi pas vrasje, lendime të rënda trupore ndersa kemi 31 raste lendime të lehta trupore nga vepra të ndryshme si rrahjet etj.

- Viedhje të rëndomta 17 raste ndersa viedhje të rënda i kemi pas 19 raste, tentim grabitje dhe grabitje nuk kemi pas.

- Dunë në familje i kemi pas 12 raste të cilat do i elaboroj në piken e veçant të rendit të ditës.
- 53 urdhëresa të Gjykates i kemi realizu. Në kohën e fundit kemi pas raste të viedhjeve të bagëtive ma shumë në zonën e pergjegjesisë. Lidhur me këto raste kemi hartuar Planë dhe kamë dhën Urdhër të veçant për ngritjen e bashkëpunimit me stacionet fqinjë si Klinë Pejë dhe Skenderaj por edhe ma largë. Lidhur me këtë Planë do na asistoj edhe Stacioni rajonal i Pejës. Nga unë kaq për këtë pik, nese ka pyetje jamë i gatshëm të pergjigjem.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - E falenderoj togerin dhe pyeti a ka dikush nga antaret pyetje apo diskutim, porë paraprakisht e pyet K-dantin si e vlerson gjendjen e sigurisë së pergjithëshme të këtij tre mujori në krahasim me tremujorin paraprak.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog - Kemi raste të veçanta ngritje apo zbritje me perqindje të vogla perjashtuar këtu viedhjet e bagëtive që ka rritje të madhe, por mund të themi se situata është stabile. Dhe e qetë perafersisht e njëjt me tremujorshin paraprak.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - E falenderoj komandantin dhe pyet anëtarët a kanë pyetje për komandantin e Policisë lidhur me Sigurinë në zonën e Pergjegjesis. Me që nuk ka kalojm në piken e radhes të rendit të ditës.

4. Informatë nga Institucionet tjera (KFOR-i, FSK-ja, Arsimi, Perfaqshues të komuniteteve etj.)

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - Pyet perfaqshuesit e KFOR-it, Arsimit dhe të komuniteteve a kanë per të paraqitur ndonjë çeshtje me që perfaqshuesin e FSK-së nuk e kemi prezent.

Me që nuk ka diskutime nga antarët dhe perfaqshuesit e theksuar më lejon që para juve ta shtroj një çeshtje që këtyre ditve e kamë pranuar nga qytetar të fsh. Veriq lidhur me një zjarr në teçen, a ka Policia ndojë informat ma detaje si dhe ju njoftoj se edhe nënkryetari shtes nga komunitetet ka qen në vendin e ngjarjes. Si konkluzion kerkoj nga Këshilli që të dalim me një komunikat që të denojm aktin e tillë sepse ne ofrojm siguri për gjitha komunitetet dhe religjionet fetare.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog - J emi njoftuar me rastin dhe ju informoj se gjitha njësit relevante kanë kryer punët e veta dhe është kompletuar lënda dhe dorzuar në Prokurori.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderon k-dantin Gashi dhe po e ngarkojm koordinatorin që ta perpiloj një deklarat me të silën KKSB-ja e denon si aktë të tillë ndaj objekteve fetare.

Me që nuk ka diskutime tjera lidhur me këtë pik kalojm në pikën e pëstë të rendit të ditës.

5. Dhuna në familje, mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore

-Diskriminimi i grave, vajzave dhe personave me aftësi të kufizuara në procedurat e konkurimit pranë institucioneve publike

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - ftoj k-dantin e Policisë që ta paraqes një raport lidhur me dhunën në familje në komunën tonë në periudhën e kaluar.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog - nga koordinatori e kamë pranuar njoftimin që ta pergatisim raportin për statistika nga data 29.06.2022. Ju informoj se nga data e theksuar deri më sotë janë paraqitur dhe inicuar gjithësejtë 37 raste në Stacionin e Policisë. Janë disa raste perseritise apo recidivistë të ndryshëm. Kemi tri familje që kanë shumë raste të perseritura. Rastet e dhunës në familje trajtohen me prioritet dhe jemi shumë të kujdesshëm në procedimin e gjitha rasteve. Ftohen zyrtar nga QPS-ja dhe gjithë zyrtarët tjer që parashihen me ligjë sepse janë raste të ndieshme. Kryersit në të gjitha rastet janë të njohur dhe lëndët janë kompletuar dhe janë procesuar në Prokurori. Nëse ka pyetje jamë i gatshëm të pergjigjem.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderoj K-dantin Gashi dhe para se të hapim debatin fjalën ja kaloj znj, Florentina Beqiraj, këshilltare e Ministrës së Drejtësisë në QRK.

-

Florentina Beqiraj, Këshilltare e Ministres së Drejtësisë - falenderon Nënkyëtarin dhe përshëndet të pranishmit. Në vazhdim prezantohet Udhëheq njësin për Drejta të njeriut pranë zyrës së Ministres, njëheri ofron mbështetje profesionale dhe teknike e koordinatores për mbrojtje nga dhuna në familje që udhëhiqet nga zv.ministri i Drejtësisë që është staf politik. Koordinatorja ka një trupë të lartë nga niveli qendrorë që bëjnë koordinimin e gjitha punëve dhe veprimeve. Në hartimin e politikave kunder dhunës në familje mbeshtetemi në Ligjin kunder dhunës në familje. Mbeshtetemi në Kushtetutën e RK-së, Konventen e Stambollit dhe kemi filluar ti harmonizojm strategjinë dhe gjitha veprimet në këtë Konventë. Bazuar në strategjinë kemi bër edhe raportin një vjeçar të cilin mund ta gjeni në veb faqen e Ministrisë ku janë të specifikuara veprimet e institucioneve perkatse për vitin 2022 si dhe konkluzionet dhe rekomandimet. Në zbatimin e strategjisë ne kemi hartuar protokolin dhe kurikulen e programeve të cilat zbatohen nga gardianët në mënyr që kryersit e veprave të dhunës në familje në momentin e kryerjes së denimit të dalin të risocializuar në familje dhe shoqëri. Kemi trajnuar një pjes të stafit korektues ku ata i mbajn trajnimet kryersve të veprave të dhunës në familje. Gjithashtu kemi krijuar edhe databazën e integruar,për dhunën në familje. Janë gjashtë institucione të cilat kanë çasje për rregjistrimin e të dhënave në këtë databaz, Prokurorija, Policija, Gjykata, QSP-ja, dhe strehimoret. Është mendu që gjitha sektoret që ofrojn sherbime për dhunën në familje të të jenë pjesë e kësaj data baze për shkak se kanë mundsi ti perciellin trendet e zhvillimeve dhe kanë mundësi të bëjn vlersimet për ndryshimin e politikave ndaj dhunës në familje. Me që është hera e parë që marrim pjes në këso takimesh, jamë mundu ti nxierri të dhënat statistikore për Istogun nga Janari 2023

deri me dje dhe tek ne janë gjashtë institucione që kanë çasje dhe mundësi të perditsojn të dhëna,. Më vije keq që k-danti doli për momentin dhe nuk është këtou që ti vlersojm a perputhën të dhënat gjegjësisht sherbimet me të dhënat e Policisë dhe të dhënat e databazës, sepse këtu kemi edhe kartelën e rastit, ku evidentohet puna e secilit akter lidhur me rastin dhe në këtë kartel ne kemi mundësi të shofim nese dikun është këputur hallka e veprimeve dhe këtu bëjm vlersimet se çfar duhet bër për ti permirsuar sherbimet në të ardhmën. Në pika të shkurta kaq ishte dhe nese ka pyetje jamë e gatshme të pergjigjem.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderon Florentinen për raportin dhe në vazhdim fton Myrvete Verbaj nga QSP-ja Istog për një raportim.

Myrvete Verbaj, Zyrtare në QSP Istog- QPS-ja Istog nga prill 2022 deri më sotë i ka trajtuar gjithësejt 16 raste. Dallimet në shifra në mes të raportit të Policisë dhe QPS-së është për arsye të recidivizmit. Nese në një familje perseritet dhuna nuk hapet rast i ri porë vazhdohet puna me të njëjtit akter. Me lajmrimin e rastit të dhunës në familje, është obligative që punëtori i QPS-së të jetë prezent dhe të merr deklaratën, me çrastpyetet viktima a deshiron të strehohet në strehimore, tek të afermit apo ndonjë zgjidhje tjetër dhe kryhet akomodimi i viktimës. Pas akomodimit të viktimes pritët 72 orë dhe më pastaj merret deklarata e dytë. Evidentohet menaxheri i rastit, ndihmohet me këshillim psikosocial, mdihmë emergjente, ndihmë fëmive dhe nese ka nevoj për ndihmë sociale. Kemi pas raste kur viktimat i kemi ndihmu me ndihmë emergjente dhe me ndihmë për banim pra sigurimi i banesës. Vjenë radha e kërkesës të Gjykates për besimin e përkohshëm të fëmijve dhe bëjm raportin e dhunës në familje. Takimi i fëmijve me prindin tjetër bazuar në kërkesën e tij, me Ligjë nuk ju lejohet që në të njëjtën kohë të jenë prezent ushtruesi i dhunës dhe viktima andaj këto takime i aranzhojmë në QPS-e. Kjo do të ishte në pika të shkurta, jam e gatshme për pyetje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderon Myrveten për raportin dhe në vazhdim hap debatin lidhur me raportet e paraqitura. Me që nuk ka pyetje lidhur me raportet ftoj zyrtaren Servete Haxhijaj për të paraqitur një raport lidhur me nënpikën e kësaj pike të rëndit të dites:

- **Diskriminimi i grave, vajzave dhe pësonave me aftësi të kufizuara në procedurat e konkurimit pranë institucioneve publike**

Servete Haxhijaj, Zyrtare për barazi gjinore - pershendet të pranishmit, sa i perket diskriminimit të grave dhe vajzave, ju informoj se jamë zyrtare për mbrojtje nga diskriminimi e emruar me Vendim të Kryetarit të Komunës. Detyrat e mija parashihen me Rregullorën NR. 03/2017. Nga momenti i marrjes së kësaj detyre nuk e kemi të paraqitur asnjë rastë si me shkrim poashtu edhe me gojë. Për punën dhe gjendjen i raportoj Avokatit të Popullit dhe zyres për qeverisjes së mirë. Edhe pse deri me tani nuk kemi pas raste të paraqitura shfrytzoj rastin dhe ju bëj apel gjithë atyre që e nijn vetën të diskriminuar për çfardo arsyeje. Njësitë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut sikurse çdo vitë tjetër edhe këtë vitë në Planin e Punes kemi parapar disa aktivitete si brenda institucionit poashtu edhe jashtë me qëllim njoftimi Drejtorët dhe punëtorët jer për detyrat tona. Nuk do zgjas më shumë me që nuk kemi raste dhe uroj

që fare mos të kemi raste diskriminimi, megjithatë edhe njëher shfrytzoj rastin që përmes juve dhe medijave tu bëj ftesë të gjitha atyre që e ndiejn veten të diskriminuar që rastin ta paraqesin në zyren tonë. Ju faleminderit.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderoj Serveten për raportin dhe hap debatin lidhur me këtë pikë.

Lumditë Idrizaj, HENDIKOS - pershendet të pranishmit, do të nderlidhem me temën e diskriminimit, mund të jetë që zyrja nuk ka njohuri por du të theksoj një rastë për të cilin ne kemi njohuri. Bëhet fjalë për një zyrtar të Komunës me aftësi të kufizuara i cili ka kërkuar një karrikë të pershtatëshme për persona me aftësi të kufizuara e i cili nga Drejtori ka marrë përgjigjen se po kërkon pak teper, megjithatë pas reagimit tek kryetari i Komunës të njëjtit i është zgjedhur problemi. Bazuar në Ligjin për persona me nevojë të veçanta i njëjti ka të drejtë në punë me orar të shkurtuarpor që në realitet ngarkohet edhe me detyra shtesë. Bazuar në këtë rastë posa#arasht dua të theksoj për institucionet por edhe për ndermarrjet tjera që të kenë kujdes në raport me persona me nevojë të veçanta e sidomos me gjinin femrore me që ato janë edhe më të ndieshme sesa gjinija mashkullore.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderon Lumditën dhe thekson se për her të parë po ndegjoj për këtë rast, megjithatë më vije mirë që qenka zgjidhur problemi sepse besoj që ky komunitet janë kategori e respektuar në shoqërinë tonë. Pra shqëtsimet e tilla ti evidentojm dhe ti adresojm në zyren e kryetarit.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave - Statistikat e paraqitura në raportet e komandantit të Policisë dhe Këshilltares së Ministres së Drejtësisë znj. Beqiraj, sikurse e paraqiti edhe vetë k-danti se ka qen kërkesa ime që në raport të perfshihen gjitha rastet nga raportimi i fundit bazuar në Planet e Punës vjetore, ndersa ngaznj Beqiraj është paraqit raporti tre mujor i këtij viti, pra për këtë arsye kemi një dalim mes shifrave të paraqitura.

Përpos kësaj desha të pyes znj. Beqiraj lidhur me strategjinë për dhunën në familje, një nga pikat parashihen edhe mjete financiare për ngritje të kapaciteteve. QPS-ja në Istog me sa unë kamë njohuri por jo vetem tek ne kanë mungesë të kapaciteteve njerzore, a jeni në dijeni cilat janë procedurat për aplikim për perfitimin e këtyre mjeteve për ngritje të kapaciteteve me që edhe ashtu është duke u trajtuar si temë që këto qëndra të kalojnë në kompetenca në kuader të Ministris së Drejtësisë.

Pyetja e dytë për. Znj. Verbaj sa i ka QSP-ja punët e koordinuara me Policin për afrimin e mbrojtjes së viktimes bazuar në Vendimin e Gjykates sepse në disa raste kur viktimat kanë psuar tragjikisht ka dalur që mungon koordinimi mes QSP-së dhe Policisë mër mbrojtjen e viktimës që ushtruesi i dhunes nuk lejohet afersia me viktimën.

Florentina Beqiraj, Këshilltare e Ministres së Drejtësisë - sa ju perket QPS-ve në janar 2023 një pjesë e tyre ka kaluar në kompetenca të Ministrisë së Drejtësisë. Pra është krijuar një grup punues për vlersimin e punës dhe nevojave të QSP-ve e cila pasë

vlersimit do të shëndrrohet në aktivitete për të vlersuar më pastaj me qëllim të ngritjes së performances.

Sa i perket buxhetimit që ju pyetet vlersimi është bër nga Ministria e Financave dhe QPS-ja mund të drejtohet me kërkesë konkrete për ngritjen e kapaciteteve, zyres së koordinatorit dhe e njëjta do të trajtohet, të analizohet çfar mund të bëhet për ngritje të kapaciteteve profesionale por jo edhe për kapacitete me burime njerzore.

Myrvete Verbaj, Zyrtare në QSP Istog- Dhuna në familje është punë shumë dimensionale dhe shumë profesionale. Në një rastë punojnë shumë profesionistë ngë lami të ndryshme. Në QSP egziston TMR-ja (Tryeza e Menaxhimit të Rastit) ku ftohen të gjithë ekspertet dhe secili e kryen punën e vetë, prezent është edhe viktima e dhunës dhe me këtë rast bëhet Plani individual i veprimit me qëllim që mos të vije deri tek riviktimizimi qoft edhe me pasoja tragjike. Çdo sektor i merr detyrat e veta dhe brenda muejit serish takohemi ku i analizojm veprimet dhe detyrat në vijim, kjo është metodologjia e punës.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog - ashtu si e theksoj edhe znj. Verbaj, kemi një bashkpunim të shkëlqyshëm me QPS-në dhe pa marrë parasysh kohen sa here i thrrasim për raste të dhunës në familje janë pergjigjë ftesës dhe na kanë ndihmu. Në një rastë në një komunitet të caktuar brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore i kemi pas gjashtë raste të dhunës në familje andaj kjo shpije në numrin e pergjithëshëm që rasteve së dhunës në familje.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - falenderon k-dantin si dhe dy parafolsit, pyet a ka diskutues tjer lidhur me këtë temë. Nese nuk ka kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.

6. Parkimi i automjeteve në trotuare-pjerrinat në trotuare pengohet levizja e lirë e qytetarëve, në veçanti e personave me nevoja të veçanta

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës - për ta paraqitur një raport ftojë Drejtorin e Urbanizmit z. Dukagjin Hoxhaj.

Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i Urbanizmit - përshendet të pranishmit, Ligji për ndertim, parasheh edhe kushtet e ndertimit për çasje të personave me nevoja të veçanta, që nga faza e planifikimit për ndertim dhe gjatë ndertimit, ndersa ndertimet e më hershme duhet të podifikohen për ti permbushur këto standarde. Gjatë vlersimit për leje ndertimore aplikacioni duhet ti plotësoj tri shtylla dhe atë. Shtylla parë, Çasja apo arritshmeria e cila në vete ngërthen mundësin e çasjes në të gjitha hapsirat e objektit, mundësin e marrjes së informatave, mundësin e levizjes dhe mobilitetit pa dallim moshe, gjinije apo aftësi. Shtylla e dytë, bazohet në barier arkitektonike e cila çdo penges që veshtirsojen apo levizjen e personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve apo fëmijve. Barrierat arkitektonike janë të nderlidhura ngushtë me barrierat institucionale dhe kulturore. Shtylla e tretë, bazohet në Udhëzimet Administrative dhe Ligjet në fuqi që u japin çasje për levizje të lirë personave me aftësi të ëkufizuara, si psh dimensionet e parkingjeve, rampat, ashensorët, platforma

ngritëse vertikale etj të cilat paraqiten me skica të dimensionuara. Në fund jepet permbajtja arkitektonik e objektit për ndertim dhe rindertim. Kjo do të ishte një permbledhje e shkurtër sa i perket objekteve, ndersa sa ju perket trotuareve më shumë ka të bëjë me Drejtoratin e Sherbimeve Publike, Drejtoratin e Inspektionit dhe Policin e Kosoves, sa gjoha i ka shkruar Policia për parkingje për persona me aftësi të kufizuara me që shpesh i shohim këto parkingje të nxana me automjete tjera.

Lumdita Idrizaj, HENDIKOS - nderlidhur me pyetjen e Drejtorit, sa vendparkingje për persona me aftësi të kufizuara janë në Istog, me që unë e di që ka qenë vetëm një vendparkim në Rr. Ibrahim Rugova e cila tani është shëndrruar në sheshë dhe nuk ka më vëndparkim, pra a mund të na tregoni në pergjithësi sa vendparkime janë.

Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i Urbanizmit - pranë objektit të komunës egziston një vëndparkim sepse e kemi pyetur edhe personin për vendin ku deshiron ta ketë vëndparkimin, ka edhe vëndparkime nëper parkingje të marketeve andaj e bëra pyetjen Policis për gjobat e shqipëtuara sepse këto parkingje në vazhdimësi nxinen nga autongasës të tjerë. Pra ka vendparkingje të rezervuara, a duhet të kemi më shumë pajtohëm që duhet të ketë vendparkingje të rezervuara.

Lumdita Idrizaj, HENDIKOS - perveç parkingut të objektit komunal që e paska rezervuar, shoqata vitin e kaluar jemi dalë sëbashku me Drejtorin e sh. Publike z. Abedin Kabashi dhe me zyrtarin Naser Nimanaj për të identifikuar vendet e nevojshme për parkingje, pengesat në vendkalime etj. Andaj ende nuk është ndertuar pjerrina tek banka Ekonomike që është identifikuar si mangsi, poashtu parkingu përball komunes dhe në afersi të Gjykates të jetë së paku një parking i rezervuar dhe ta ketë shenjën dhe simbolin në asallt që është vëndparkim i rezervuar për persona me aftësi të kufizuara, pra ende nuk janë permbush kerkesat tona, ndersa unë kamë njohuri që zyrtarin me aftësi të kufizuara e kanë detyru ta largojn automjetin nga vëndparkimi , këto janë njohurit që kamë unë per këtë moment. Ndersa sa ju perket Policis në vend se të marrin masa ndaj ngasësve të automjeteve që nxanë vëndparkimet e rezervuara këta vetë e kanë bër një gjë të tillë që ua kemi deshmua disa her me fakte në Rr. Ibrahim Rugova.

Dukagjin Hoxhaj, Drejtor i Urbanizmit - jemi në konsulltime me Drejtorin Abedin kabashi dhe jemi në dijeni me kerkesat e shoqates dhe në momentin që na ipet mundsia do të realizohen me që po kemi probleme edhe me Operatorët Ekonomik të cilët mund ti realizojn këto kërkesa. Pra në çastin e parë që do të kemi mundësi do ti realizojmë këto kërkesa.

Kap. Enver Gashi, Komandant i St. Policis Istog - në prezntimin në fillim e paraqita se Policia ka shqiptuar për tremujorin 462 gjoha, por per momentin nuk i kamë të ndara dhe marrë persiper që në takimin e radhes tju informoj ose permes telefonit do tju njoftoj me këtë statistik. Poashtu pajtohëm plotësishtë me diskutimin e Lumëditës.

..

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës – me që nuk ka debatues të tjer lidhur me këtë pikë, ather kalojm në piken e radhës të ndryshme.

7. Të ndryshme

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave – bazuar në UA unë jami i obliguar ti percielli pjesmarrjen në mbledhje, me që mospjesmarrja në tri mbledhje radhazi duhet ndermarr masa për zavendsimin e antarit të KKSBB-së. Robert Gegaj si perfaqshues i Këshillit të Prindërve në KKSBB nuk ka marr pjesë në kater mbledhjet. Pyetje për Drejtorin e DKA-së a është ende perfaqshues z. Gegaj apo është zgjedhur dikush tjetër. Bazuar në këtë fakt do të duhej të inicohet procedura e rizgjedhjes së Kryetarit sepse zëri i Këshillit të prindërve nuk perfaqshohet në këtë Këshill. Poashtu edhe perfaqshuesi i Kishës Katolike Don Alfred Sokoli nuk është i rregulltë në mbledhje.

Naim Behlulaj, Drejtor i Drejtoratit për Arsim – pershendet të pranishmit. Roberti është ende kryetar i Këshillit të prindve por gjindet jashtë vendit me një projekt. Unë e kamë kontakti sepse edhe DKA-ja ka nevoj për hartiomin e Planit Zhvillimor të DKA-së dhe ka deklaruar se permes emailit do të mundohet të jap kontributin.

Ali Nimanaj, Nënkyetar i Komunës – lidhur me shqetsimin që ngriti Skenderi, unë do të kerkoja nga ti si koordinator që ti kontaktojsh personalisht dhe ti marrësh arsyet e mungesave. Me që nuk ka diskutues tjerë ju falenderoj në kontributin e dhën në mbledhje dheme kaq e perfundojm këtë mbledhje.

Mirupafshim në takimet e radhes.

Mbledhja perfundoj:

11.10